



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E VERIFIKIMIT**

VENDIM

Nr. 12 Datë 18.01 2018

PËR

**MIRATIMIN E NJË SHTESE NË SHTOJCËN 17
TË DOKUMENTAT STANDARDE TË TENDERIT
PËR PROCEDURËN “SHËRBIM KONSULENCE”**

Në mbështetje të shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 13 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe nenit 11, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Agjencia e Prokurimit Publik

Vendos:

Në Dokumentat Standarde të Tenderit për Procedurën e Prokurimit “**Shërbim Konsulence**”, të miratuara me Vendimin Nr.7, datë 12.01.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik, bëhet ky ndryshim:

1. Shtojca nr. 17 “Njoftim Fituesi”, riformulohet sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi dhe bëhet pjesë e setit të dokumentave standarde të tenderit për procedurën e prokurimit “Shërbim Konsulence” .

2. Për procedurat e prokurimit “Shërbim Konsulence” që do të shpallen pas datës **23/07/2018**, autoritetet kontraktore duhet të përdorin dokumentat standarde të tenderit për procedurën “Shërbim Konsulence”, të rishikuara me këtë vendim.

3. Ngarkohen autoritetet kontraktore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të APP në datë 18/07/2018 dhe hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Reida Kashta

